

LIGJ
Nr. 68/2025

**PËR PRANIMIN E NDRYSHIMEVE TË STATUTIT TË ROMËS PËR GJYKATËN
NDËRKOMBËTARE PENALE PËR KRIMIN E AGRESIONIT, RATIFIKUAR
ME LIGJIN NR. 8984, DATË 23.12.2002**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pranohen ndryshimet e Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale për krimin e agresionit, bërë në Kampala, më 11 qershor 2010, ratifikuar me ligjin nr. 8984, datë 23.12.2002, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 4.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 485, datë 17.12.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

(XVIII. 10)

ADRESA POSTARE – ADRESSE POSTALE. UNITED NATIONS, N.Y. 10017
ADRESA KABLLORE – ADRESSE TELEGRAPHIQUE UNATIONS NEW YORK

Referencë: C.N.651.2010.TREATIES-8 (Njoftim për depozituesin)

STATUTI I ROMËS PËR GJYKATËN NDËRKOMBËTARE PENALE
ROMË, 17 KORRIK 1998
NDRYSHIME NË STATUTIN E ROMËS PËR GJYKATËN NDËRKOMBËTARE PENALE

KAMPALA, 11 QERSHOR 2010
MIRATIMI I NDRYSHIMEVE PËR KRIMIN E AGRESIONIT

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, duke vepruar në cilësinë e tij si depozitues, raporton si vijon:

Më 11 qershor 2010, në Konferencën e Rishikimit të Statutit të Romës, të mbajtur në Kampala, Uganda, nga data 31 maj deri më 11 qershor 2010, në përputhje me nenin 121, pika 3, të Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale, Palët miratuan ndryshimet për krimin e agresionit në Statutin e Romës nëpërmjet rezolutës RC/Res.6.

Në përputhje me nenin 123, pika 3, të Statutit të Romës, dispozitat e nenit 121, pikat 3 deri në 7, vënë në zbatim miratimin dhe hyrjen në fuqi të çdo ndryshimi të Statutit të marrë në konsideratë në Konferencën e Rishikimit.

Neni 121, pikat 3, 4, 5, 6 dhe 7 parashtrojnë, si më poshtë:

“3. Miratimi i një ndryshimi në mbledhjen e Asamblesë së Shteteve Palë ose në Konferencën e Rishikimit, për të cilin nuk arrihet konsensus, kërkon shumicën me dy të tretat e Shteteve Palë.

4. Ndryshimi hyn në fuqi për të gjitha Shtetet Anëtare një vit pas depozitimit te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara të instrumenteve të ratifikimit, ose të pranimit, me shtatë të tetat e tyre, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe në pikën 5.

5. Çdo ndryshim i neneve 5, 6, 7 dhe 8 të këtij Statuti do të hyjë në fuqi për ato Shtete Palë që e kanë pranuar ndryshimin një vit pas depozitimit të instrumenteve të tyre të ratifikimit, ose të pranimit. Për sa i përket një Shteti Anëtar që nuk e ka pranuar ndryshimin, Gjykata nuk do të ushtrojë juridiksionin e saj për një krim që mbulohet nga ky ndryshim në rast se kryhet nga shtetasit e atij Shteti Anëtar ose në territorin e tij.

6. Nëse një ndryshim pranohet nga shtatë të tetat e Shteteve Palë, në përputhje me pikën 4, çdo Shtet Palë që nuk e ka pranuar ndryshimin mund të tërhiqet nga ky Statut me efekt të menjëhershëm, pavarësisht nenit 127 pika 1, por duke zbatuar nenin 127, pika 2 për të njoftuar jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi.

7. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet t’u qarkullojë të gjitha Shteteve Anëtare çdo ndryshim të miratuar në mbledhjen e Asamblesë së Shteteve Palë ose në Konferencën e Rishikimit.”

(XVIII. 10)

Në paragrafin kryesor 1 të rezolutës RC/Res.6, Konferenca e Rishikimit, në përputhje me nenin 5, pika 2 të Statutit të Romës së Gjykatës Ndërkombëtare Penale miratoi ndryshimet në Statut të përfshira në shtojcën 1 të rezolutës, “që janë objekt i ratifikimit, ose i pranimit, dhe hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 121, pika 5”.

Një kopje e tekstit të ndryshimeve për krimin e agresionit në gjuhët arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle përcillet nëpërmjet këtij dokumenti.

29 nëntor 2010

[Nënshkrimi]

Kujdes! Shërbimet e Traktateve të Ministrive të Punëve të Jashtme dhe të organizatave ndërkombëtare të përfshira. Njoftimet për depozituesin jepen vetëm në format elektronik. Njoftimet për depozituesin u vihen në dispozicion Misioneve të Përherëshme në Kombet e Bashkuara në koleksionin në internet të Traktateve të Kombeve të Bashkuara, në faqen: <http://treaties.un.org>, te “Njoftimet për depozituesin (CNS)”. Për më tepër, Misionet e Përherëshme edhe individët e tjerë të interesuar, mund të pajtohen për të marrë me *email* njoftimet për depozituesit nëpërmjet “Shërbimeve të automatizuara të abonimit”, në seksionin e traktateve, që, gjithashtu, disponohet në faqen: <http://treaties.un.org>.

Ndryshime në Statutin e Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale për krimin e agresionit

1. Neni 5, pika 2, i Statutit është fshirë.

2. Teksti vijues është futur pas nenit 8 të Statutit:

Neni 8 bis

Krimi i agresionit

1. Për qëllime të këtij Statuti, “krimi i agresionit” nënkupton planifikimin, përgatitjen, fillimin ose ekzekutimin prej një personi me një pozicion që ushtron kontroll mbi, ose që drejton veprimet politike ose ushtarake të një Shteti të një veprimi agresioni, i cili nga karakteri, rëndësia dhe shkalla përbën një shkelje të hapur të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

2. Për qëllime të paragrafit 1, “akti i agresionit” nënkupton përdorimin e forcave të armatosura nga një Shtet kundër sovranitetit, integritetit territorial ose pavarësisë politike të një Shteti tjetër, apo në ndonjë mënyrë tjetër që nuk është në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara:

a) Pavarësisht nëse është shpallur luftë, në përputhje me rezolutën 3314 (XXIX) të datës 14 dhjetor 1974 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, secili prej veprimeve vijuese do të cilësohet si veprim agresioni: pushtimi ose sulmi nga forcat e armatosura nga një Shtet i territorit të një Shteti tjetër, ose çdo pushtim ushtarak, edhe pse i përkohshëm, që rezulton nga një pushtim ose sulm i tillë, ose çdo aneksim me forcë i territorit të një Shteti tjetër ose i një pjese të tij;

b) Bombardimi nga forcat e armatosura të një shteti kundër territorit të një Shteti tjetër ose përdorimi i çdo arme nga një Shtet kundër territorit të një Shteti tjetër;

c) Bllokimi i porteve ose i brigjeve të një Shteti nga forcat e armatosura të një Shteti tjetër;

d) Sulmi nga forcat e armatosura të një Shteti mbi forcat tokësore, detare ose ajrore ose flotat detare dhe ajrore të një Shteti tjetër;

e) Përdorimi i forcave të armatosura të një Shteti, të cilat janë brenda territorit të një Shteti tjetër me konsensusin e Shtetit marrës, në kundërshtim me kushtet e parashikuara në marrëveshje ose çdo shtyrje e pranisë së tyre në këtë territor përtej mbarimit të marrëveshjes;

f) Veprimi i një Shteti i cili ofron territorin e tij, të cilin e ka vendosur në dispozicion të një Shteti tjetër, që të përdoret nga ai Shtet tjetër për të kryer një veprim agresioni kundër një Shteti të tretë;

g) Dërgimi nga ose për llogari të një Shteti i bandave, grupeve të armatosura, guerilëve ose mercenarëve, që kryejnë veprime të armatosura kundër një Shteti tjetër të një rëndësie të tillë, sa t'u shtohen veprimeve të renditura më sipër, apo të kenë një përfshirje të konsiderueshme në të.

3. Teksti vijues është futur pas nenit 15 të Statutit:

Neni 15 bis

Ushtrimi i juridiksionit mbi krimin e agresionit

(Referuar shteteve, *proprio motu*)

1. Gjykata mund të ushtrojë juridiksion mbi krimin e agresionit në përputhje me nenin 13, pikat (a) dhe (c), që është objekt i dispozitave të këtij neni.

2. Gjykata mund të ushtrojë juridiksion vetëm në lidhje me krimet e agresionit të kryera një vit pas ratifikimit ose pranimit të ndryshimeve nga tridhjetë Shtetet Anëtare.

3. Gjykata do të ushtrojë juridiksion mbi krimin e agresionit në përputhje me këtë nen, që është objekt i vendimit që do të merret pas datës 1 janar 2017 nga e njëjta shumicë e Shteteve Anëtare siç kërkohet për miratimin e një ndryshimi në Statut.

4. Në përputhje me nenin 12, Gjykata mund të ushtrojë juridiksion mbi një krim agresioni, që rezulton nga një veprim agresioni i kryer nga një Shtet Palë, përveçse nëse ai Shtet Palë ka deklaruar më parë që nuk e pranon këtë juridiksion, duke depozituar një deklaratë te Sekretari i Gjykatës. Tërheqja e një deklarate të tillë mund të kryhet në çdo kohë dhe duhet të merret në konsideratë nga Shteti Palë brenda tre vjetëve.

5. Për sa i përket një Shteti që nuk është palë në këtë Statut, Gjykata nuk duhet të ushtrojë juridiksionin e saj mbi krimin e agresionit kur kryhet nga shtetasit e atij Shteti ose në territorin e tij.

6. Aty kur Prokurori arrin në përfundimin se ka një bazë të arsyeshme për të proceduar me hetimin, në lidhje me një krim agresioni, ai ose ajo duhet fillimisht të sigurohet nëse Këshilli i Sigurimit e ka cilësuar si agresion veprimin e kryer nga Shteti në fjalë. Prokurori duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara rreth situatës përpara se çështja të shkojë në Gjykatë, duke përfshirë çdo informacion dhe dokument të rëndësishëm.

7. Aty ku Këshilli i Sigurimit ka bërë një përcaktim të tillë, Prokurori mund të vijojë me hetimin në lidhje me krimin e agresionit.

8. Në rast se një cilësim i tillë nuk bëhet brenda gjashtë muajve pas datës së njoftimit, Prokurori mund të vijojë me hetimin në lidhje me krimin e agresionit, me kusht që Divizioni i shqyrtimit paraprak të çështjes ka autorizuar fillimin e hetimit, në lidhje me krimin e agresionit, në përputhje me procedurën që përmban neni 15 dhe se Këshilli i Sigurimit nuk ka vendosur ndryshe në përputhje me nenin 16.

9. Cilësimi i një veprimi agresioni nga një organ jashtë Gjykatës nuk do të cenojë gjetjet e vetë Gjykatës sipas këtij Statuti.

10. Ky nen nuk cenon dispozitat që lidhen me ushtrimin e juridiksionit, në lidhje me krimet e tjera referuar në nenin 5.

4. *Teksti vijues është futur pas nenit 15 bis të Statutit:*

Neni 15 *ter*
Ushtrimi i juridiksionit mbi krimin e agresionit
(Referuar Këshillit të Sigurimit)

1. Gjykata mund të ushtrojë juridiksion mbi krimin e agresionit në përputhje me nenin 13, pika (b), që është objekt i dispozitave të këtij neni.

2. Gjykata mund të ushtrojë juridiksion vetëm në lidhje me krimet e agresionit të kryera një vit pas ratifikimit ose pranimit të ndryshimeve nga tridhjetë Shtete Anëtare.

3. Gjykata do të ushtrojë juridiksion mbi krimin e agresionit në përputhje me këtë nen, që është objekt i vendimit që do të merret pas datës 1 janar 2017 nga e njëjta shumicë e Shteteve Anëtare, siç kërkohet për miratimin e një ndryshimi në Statut.

4. Cilësimi i një veprimi agresioni nga një organ jashtë Gjykatës nuk do të cenojë gjetjet e vetë Gjykatës sipas këtij Statuti.

5. Ky nen nuk cenon dispozitat që lidhen me ushtrimin e juridiksionit, në lidhje me krimet e tjera referuar në nenin 5.

5. *Teksti vijues është futur pas nenit 25, pika 3 të Statutit:*

3 bis. Për sa i përket krimit të agresionit, dispozitat e këtij neni duhet të zbatohen vetëm për personat që kanë një pozicion nga i cili mund të ushtrojnë kontroll mbi, ose të drejtojnë veprimet politike, ose ushtarake të një Shteti.

6. *Fjalja e parë e nenit 9, pika 1 e Statutit është zëvendësuar me fjalinë e mëposhtme:*

1. Elementet e krimit do të ndihmojnë Gjykatën në interpretimin dhe zbatimin e neneve 6, 7, 8 dhe 8 bis.

7. *Hyrja e nenit 20, pika 3, e Statutit është zëvendësuar nga paragrafi vijues. Pjesa tjetër e paragrafit mbetet e pandryshuar:*

3. Asnjë person i cili është gjykuar nga një gjykatë tjetër për sjellje që parashikohen në nenet 6, 7, 8 ose 8 bis nuk do të gjykohet nga Gjykata, në lidhje me të njëjtën sjellje, përveçse nëse procedurat gjyqësore në gjykatën tjetër

Nëpërmjet këtij dokumenti vërtetohet se teksti i mësipërm është kopje e vërtetë e ndryshimeve për krimin e agresionit të Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale, miratuar më 11 qershor 2010, në mbledhjen plenare të 13-të të Konferencës së Rishikimit të Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale, që u mbajt në Kampala, Uganda, nga data 31 maj deri më 11 qershor 2010.

Për Sekretarin e Përgjithshëm, zëvendëssekretari i përgjithshëm përgjegjës për zyrën e çështjeve ligjore Je certifie que le texte qui precede est unacopie conforrae des Amendements sur le crime d'agression du Statut de Rome de la Cour Pénale Internationale, adoptés le 11 Jum 2010 a la treizieme seance plémère de la Conference de revision du Statut de Rome de la Cour Pénale Internationale, tenue a Kampala, en Ouganda, du 31 mai au 11 jum 2010.

Pour le Secretaire general,

Le Sous-Secrètaire general charge du Bureau des affaires juridiques

Stephen Mathias

[Nënshkrimi]

Kombet e Bashkuara, Nju-Jork

29 nëntor 2010

Organisation des Nations Unies New York,

le 29 novembre 2010

